

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, - Departamenti i Krimeve të Rënda, përmes kryetarit të trupit gjykues – gjyqtarit Agim Ademi, me sekretaren juridike Fikrete Destani, në lëndën penale kundër të akuzuarit K.S. , nga Gjilani Lagja “”, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokat .. nga Gj , për shkak të veprës penale blerja, posedimi dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2. lidhur me paragrafin 1. të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda PP.I. nr.202/2016, të datës 30.08.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 02.09.2016, bie dhe në prezencë të palëve publikisht shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

I akuzuari K.S. , nga i ati H., dhe nëna M. , e lindur R. , i lindur me date ...në Gjilan , ku edhe jeton, i pa martuar, i pa punë, ka të kryer shkollën e mesme ekonomike, i gjendjes se mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Më datën 10.08.2016, rreth ores 12:30 h, në udhëkryqin me dashje dhe pa autorizim , ka blerë dhe poseduar me qëllim të shpërndarjes dhe shitjes substancë narkotike të llojit “...” e cila me ligj është shpallur si substance e rrezikshme, në atë mënyrë që ditën kritike, derisa i akuzuari ishte duke drejtuar automjetin e markës Golf III , me tabela regjistrimi, ndalet për kontroll nga zyrtarët policor, ku gjatë kontrollimit

në xhep i gjenden dhe sekuestrohen 35 paketime me substance narkotike, të mbështjella me letër alumini, të përgatitura për shpërndarje dhe shitje, e që pas analizave të testit fushor, substance narkotike e sekuestruar ka dhënë rezultat pozitiv të llojit "...", me peshë totale prej gram dhe të cilën i pandehuri kishte për qëllim që ta shpërndante – dërgonte personin të quajtur M. nga fshati Zh. Komunës e Gj.

-Me çka ka kryer veprën penale blerja , posedimi , shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve , substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 7,17,21,41,45,46,69,73,75,76,83,114, nenit 273 par 5 të KPRK si dhe neneve 365 dhe 453 të KPPRK-ës .

E GJYKON

Të akuzuarin K.S. , me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj burgim, të cilin dënim i njëjti do ta vuaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishme të aktgjykimit, e në të cilin dënim ka për t'iu llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt. 10.08.2016 deri më datën 02.09.2016. Po ashtu të njëjtit i shqiptohet edhe dënimi me gjobë në lartësi prej 200 (dyqind) euro, e të cilën dënim me gjobë do ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën dënim me gjobë do ti zëvendësohet në dënimi me burg, llogaritur 20 euro për 1 ditë burgimi.

Të akuzuarit i shqiptohet edhe dënimi plotësues konfiskimi i substancës narkotike të llojit "...” prej 35 paketimeve në peshë prej 14.5 gramë.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 (tridhjetë) euro, si dhe shpenzimet e procedurës sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Gjilan,- Departamenti për Krimeve të Rënda ka paraqitur aktakuzë PP.I. nr. 202/2016, të datës 30.08.2016, kundër të akuzuarit K.S. , nga Gjilani, për shkak të veprës penale blerja, posedimi dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2. lidhur me paragrafin 1.të KPRK-ës, dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtorë dhe të dënohet me dënim meritor sipas ligjit.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, Arben Kadriu në deklarimin e tij shtoi se mbetem në tërësi pranë aktit akuzues dhe lidhur me dënimin deklaron se duhet patur parasysh rrethanat rënduese dhe atë shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale, rrezikshmërinë e veprave penale se te këto vepra penale viktimat janë në moshë të re gjegjësisht fëmijë, ndërsa si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Mbrojtësi i të akuzuarit avokat S.M, deklaroi: se meqë i mbrojturi im e ka pranuar fajësinë nuk do të lëshohem lidhur me gjendjen faktike ose ekzistimit apo mosekzistimit të veprës penale por me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit nga ana e gjykatës kërkojmë që të merr parasysh rrethanat lehtësuese dhe atë veçanërisht pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit përkatësisht gjendjen e tij se është i moshës së re, i njëjti është person- përdorues i substancës narkotike i këtij lloji, jetojnë në kushte të varfra ekonomike , nuk ka qen i dënuar më parë, dhe me një dënim të kushtëzuar në një afat optimal ligjor besoj që mund të arrihet qëllimi i ndëshkimit të dënimit

I akuzuari K. S fillimisht e pranoi fajsinë për veprën penale e cila i vebet në barrë e më tej shtoi se jam penduar shumë për këtë vepër penale dhe se i premtoi gjykatës se më nuk do të kryej vepra tjera penale, andaj kërkoi nga Gjykata që ti shqiptohet një dënim sa më i but që është e mundur.

Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, të lëshuar në emër të akuzuarit K.S. te datës 10.08.2016, raporti i testit fushor i datë 10.08.2016, foto dokumentacionit, dëshmisë së dëshmitares F.Sh si dhe me vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit erdhi në përfundim se i akuzuari K.S. ka kryer veprën penale blerja, posedimi dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2. lidhur me paragrafin .1 të KPRK-ës.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit Gjykata pati parasysh rrethanat të parapara me nenit 73 të KPRK-ës, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari ka shprehur keqardhje të thellë për kryerjen e kësaj vepre penale, ka pas sjellje të mirë në Gjykatë, premtimi i tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, lloji i substancës narkotike dhe si rrethanë veçanërisht lehtësuese pranimin e fajësisë në seancën për shqyrtim fillestar i cili pranim ishte bindës dhe i plotë. Ndërsa si rrethanë rënduese pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale të kësaj natyre duke qenë se përdorues të këtyre substancave janë kryesisht gjenerata e reja. Andaj, në prezencë të rrethanave të shumta lehtësuese gjykata në zbatim të dispozitave mbi zbutjen e dënimit nga neni 75 dhe 76 të KPRK-së të akuzuarit i shqiptoi dënim nën minimumin ligjor të dënimit të paraparë me burgim, me bindje se edhe me një dënim të tillë të shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-së. Me rastin e matjes së dënimit me gjobë është marr parasysh gjendja materiale për fakti se i akuzuari nuk është i punësuar dhe nuk realizon të ardhura,

Gjithashtu në pajtueshmëri me dispozitën 273 par.5 lidhur me nenin 62 par.2 pika 2.7 të KPRK-së, gjykata të akuzuarit i shqiptoi edhe dënimin plotësues konfiskimin e substancave narkotike, të llojit “...” prej 35 paketimeve në peshë prej 14.5 gramë, të sekuestruar përkohësisht nga ana e Policisë së Kosovës – Drejtoria e Hetimeve të Trafikimit të Narkotikëve – Gji. me date....

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr. 204/2016 Me datë. 02.09.2016

Sekretarja juridike,
Fikrete Destani

Kryetari i trupit gjykues,
Agim Ademi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti për Krimeve të Rënda, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të së njëjtës, ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj Gjykate.

